



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0176

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Agon Ramadani - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Albo Group SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të KOMUNA SUHAREKË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Vlersimi rapid i shkollave - faza e parë me numër të prokurimit 624-22-13949-2-2-1, me 29/06/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE Albo Group SH.P.K. me nr. 2023/0176 , e datës 31/03/2023, kurse vendimi i AK KOMUNA SUHAREKË lidhur me aktivitetin e prokurimit Vlersimi rapid i shkollave - faza e parë me numër të prokurimit 624-22-13949-2-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim.**

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Albo Group SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 02.01.2023, Komuna e Suharekës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Vleresimi rapid i shkollave-faza e parë” me nr. të prokurimit: "624-22-13949-2-2-1". Nderkaq me datën 01.03.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE “Albo Group” shpk me datën 17. 03. 2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 21. 03. 2023, AK- KK Suharekë me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Albo Group” shpk, me datën 31.03.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 176/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 15.000.00€.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 07.04.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet si e bazuar
- të anulohet B58-njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Sqarim Hyrës

Autoriteti Kontraktues -Kuvendi i Komunës Suharekë, gjatë këtij aktiviteti ka aplikuar procedurën e kufizuar, vlerë e madhe, lloji i kontratës punë, vlera e parashikuar 15.000.00 €

Grupi i OE ankues, i pakënaqur me vendimin e AK-së me dt. 31.03.2023 paraqet ankesë në OSHP me pretendime të njëjta ankimore duke shtuar edhe pretendime lidhur me arsyeshmerinë e vendimit të AK- së.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “ Albo Group ” ankues të aprovohet e bazuar, dhe rekomandon që të anulohet B58 - Njoftimi mbi Vendimin AK dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

-Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të gjithmbarshëm të shkresave të kësaj lënde, pretendimeve ankimore dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues konsideron se gjetjet dhe rekomandimet e tij janë të pranueshme dhe si rrjedhojë Paneli vendosi që ankesa “Albo Group ” sh.p.k të aprovohet

si e bazuar.

Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe natyrën e një çështje në rastin konkret, lidhur me ankesën si objekt shqyrtimi në relacion me pretendimet ankimore të parashtruara në këtë ankesë, PSH deri tek vendim-marrja përfundimtare ka arritur duke konsideruar pikat kyçe përcaktuese të cilat kanë orientuar drejt vendimit sikur në dispozitiv, çështjet përcaktuese janë konsideruar çështjet e ngritura nga ana e OE ankues kundrejt eliminimit të tij nga ky aktivitet prokurimi si dhe përkundër anulimit të tërësishëm të procedurës nga ana e AK-së, konkretisht pretendimet lidhur me mos-përmbushjen e kriterit tek Kapaciteti teknik dhe profesional: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar projekte të ngjashme në tre vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë së paku prej 20,000.00 Euro, me arsyetimin se OE ankues nuk ka realizuar projekte të ngjashme në tre vitet e fundit .

Lidhur me këtë pretendim ankimor, PSH ka konsideruar poashtu konstatimet e ekspertit shqyrtues se Operatori ekonomik ankues ka ngarkuar në platformën elektronike e-prokurimi, ka ofruar listën e kontratave të nënshkruar dhe të vulosur, me vlerë totale: 115,500.97 euro duke i bashkangjitur Referencat dhe raportet e pranimi lidhur me këto kontrata, e poashtu veprimet e ndërmarra nga ana e AK-së me ç'rast nga dy (2) komisione të ndryshme që është vlerësuar ekzaminuar dhe krahasuar kanë dhënë rekomandime të ndryshme si dhe ZPP në kërkesën për rishqyrtim nxjerr vendim mbi refuzimin e KpR, kështu që si rrjedhojë tek pjesa e arsyetimit pranon vetëm një kontratë: Shërbimet e trajnimit për stafin e Universitetit në vlerë: 3.540.00 Euro, ndërsa kontratat tjera nuk janë pranuar duke deklaruar se të njëjtat nuk janë të ngjashme, PSH lidhur me këtë rast konstaton se arsyetimi i dhënë në eliminim e poashtu në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim ka qenë i mangët në aspektin sqarues, duke mos e argumentuar dhe arsyetuar mjaftueshëm, andaj PSH konstaton se mbështet konstatimin e ekspertit shqyrtues se AK me këtë veprim nuk ka respektuar nenin 59 par. 4 të LPP-së, ku thotë: *”Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”*, si dhe nenin 7 par. 2 të LPP-se , citim : *“Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik”*, përveç tjerash PSH konstaton se veprimi i tillë i ndërmarrë nga ana e AK-së bie poashtu ndesh me nenin 108/A (zgjidhja preliminare e mos-marrëveshjeve), konkretisht paragrafi 9 parasheh që në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim :” 9. Refuzimi

do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj”, andaj rrjedhimisht PSH konstaton se duke qenë se në DT është saktësuar se OE të interesuar të paraqesin kontrata të “ngjashme” me aktivitetin relevant, AK duhet në mënyrë të specifikuar të paraqesë konkludimet në bazë të së cilave është arritur vendimi relevant, përkatësisht arsyetimet në aspektin e ngjashmërisë të kontratave të paraqitura, lidhur me këtë çështje, PSH konsideron se si pika përcaktuese në rastet kur AK nuk saktëson në kërkesa të DT dhe NJK se cilat kontrata/punë konsiderohen të ngjashme me aktivitetin konkret (duke dhënë shembuj), bazuar në rastet e kaluara që si rrjedhojë kanë pasur pretendime të ngjashme/njëjta, vendimmarrja sa i përket këtyre çështjeve është arritur duke analizuar punët/shërbimet që parashikohen të zbatohen, qoftë në paramasë apo projekt-dizajn të aktivitetit, e pastaj krahasimi i tyre me punët/aktivitetet e përcaktuara në kontratat e referuara si dhe aktivitetin përkatës.

Andaj rrjedhimisht PSH konstaton se lidhur me këtë aktivitet duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i rivlerësimit, nuk ka respektuar nenin 7, 59, 60, 62 të LPP-së, dhe nenin 40 të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim Publik, sepse Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të bëhet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP-se, në këtë aktivitet të prokurimit, në mënyrë që të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 në dosje të tenderit si dhe të respektohen kriteret e dhënies.

- Përfundim –

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vlerëson se aktiviteti i prokurimit duhet të rivlerësohet në mënyrë që B58 njoftimi mbi vendimin e AK të anulohet dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri vlerësim dhe të zbatohen dispozitat ligjore të LPP.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - Albo Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: